



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2018:016309

Datë: 31.05.2022

Numri i dokumentit: 03081559

**P.nr.808/16**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i Përgjithshëm Penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani, me asistimin e praktikantit Arton Cokli në cilësi të procesmbajtësit, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.U me vendbanim në rrugën “...” nr.5 në Ferizaj, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar: PP/II.nr.316-4/15 e datës 26 Gusht 2016, pas shqyrtimit gjyqësor dhe publik të mbajtur në praninë e prokurorit të shtetit Luljeta Bilalli, të dëmtuarit E.T si dhe të akuzuarit V.U, më datën 16 Maj 2022, morri dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 31 Maj 2022, përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I akuzuari: V.U**, i lindur me datë ..., nga i ati H. dhe e ëma B. e gjinisë H., me vendbanim në rrugën “...” nr.5 në Ferizaj, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në firmën E..., shqiptar, shtetas i R.Kosovës.

**Konform nenit 363 par. 1 pika 1.3 të KPP-ës**

### **REFUZOHET AKTAKUZA**

Sepse me datë 30 Shtator 2014 në rrugën “...” në Ferizaj, i akuzuari kishte shkuar tek lokali i të dëmtuarit E.T, e ka kanosur të dëmtuarin me fjalët “mos më dil më kurr përpara” ku me atë

atë rast ka nxjerrë një revole me të cilën e ka kanosur, kjo kanosje ka shkaktuar shqetësim dhe frik tek i dëmtuari.

**me këtë do të kryente veprën penale kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK-së.**

- Për shkak se në këtë çështje penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.
- I dëmtuari E.T me vendbanim në rrugën “....” nr.39 në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet ne kontest civil.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën e evidentuar si: PP/II.nr.316-4/15 e datës 26.08.2016, kundër të akuzuarit V.U me vendbanim në rrugën “....” nr.5 në Ferizaj, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK-ës.

Gjykata, duke vepruar sipas kësaj akuze, ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 18 Janar 2021, ku i akuzuari V.U është deklaruar i pafajshëm për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 16 Maj 2022, prokurori i shtetit ka bërë rikualifikimin e veprës penale kanosje nga neni 185 par.4 në nenin 185 par.1 të KPRK-ës, pasi që gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk u vërtetua se kjo kanosje kishte ndodhur përmes armës.

Pas rifkualifikimit të veprës penale nga ana e prokurorit të shtetit, dënimi i paraparë nga dispozita 185 par.1 të KPRK-ës parashihet të jetë dënim me burgim deri në gjashtë (6) muaj, vepra penale pretendohet të jetë kryer me datë 30.09.2014.

Bazuar ne nenin 106 i cili rregullon parashkrimin e ndjekjes penale, sipas paragrafit 1 pika 1.6 të kësaj dispozite është paraparë që ndjekja penale për veprat penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 2 vite nga data e kryerjes së veprës penale (**parashkrimi relativ i ndjekjes penale**), ndërsa në bazë të nenit 107 par.1 dhe 8 të

KPRK-së, është paraparë se ndjekja penale ndalohet ne çdo rast kur te ketë kaluar dyfishi i kohës se afatit te parashkrimit (**parashkrimi absolut i ndjekjes penale**), çka rezulton se deri me datën e këtij vendimi kane kaluar mbi katër (4) vite nga koha e kryerjes e veprës penale dhe rrjedhimisht në këtë çështje penale ka ndodhur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Konform nenit 463 par.3 të KPP-ës, palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore e udhëzon në kontest civil.

Konform nenit 454 par. 1 të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimit e paushallit gjyqësor bien ne barre te buxhetit te shtetit.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**Departamenti i Përgjithshëm Penal,**  
**P.nr.808/16 i datës 31 Maj 2022**

**Praktikanti:**

Arton Cokli

**Gjyqtarja:**

Mimoza SHABANI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.